




RAJONET ME **ENERGJI** **POZITIVE**

PËR BANORËT DHE
PËR MJEDISIN

RAJONET ME ENERGJI POZITIVE PËR BANORËT DHE PËR MJEDISIN

This publication is based upon work from COST Action Positive Energy Districts European Network, CA19126, supported by COST (European Cooperation in Science and Technology).

COST (European Cooperation in Science and Technology) is a funding agency for research and innovation networks. Our Actions help connect research initiatives across Europe and enable scientists to grow their ideas by sharing them with their peers. This boosts their research, career and innovation.

www.cost.eu

© PED-EU-NET 2024. Unless otherwise stated, material in this publication may be freely used, shared, copied, reproduced, printed and/ or stored, provided that appropriate acknowledgement is given to PED-EU-NET as the source and copyright holder. Material in this publication that is attributed to third parties may be subject to separate terms of use and restrictions, and appropriate permissions from these third parties may need to be secured before any use of such material.

About PED-EU-NET. The COST Action CA19126 PED-EU-NET 'Positive Energy Districts European Network' drives the deployment of PEDs by harmonising, sharing, and disseminating knowledge and breakthroughs on PEDs across different stakeholders, domains, and sectors at the national and European level. It aims at establishing a PED innovation eco-system to facilitate open sharing of knowledge, exchange of ideas, pooling of resources, experimentation of new methods and co-creation of novel solutions across Europe. Additionally, this COST Action supports the capacity building of new generation PED professionals, Early Career Investigators as well as experienced practitioners. Its main goal is to mobilise relevant actors from and across Europe to collectively contribute to the long-term climate neutral goal.

Citation: COST Action CA19126 PED-EU-NET (2024), Positive Energy Districts for People and the Environment, COST Action CA19126 Positive Energy Districts European Network, Brussels.

Available for download: <http://www.pedeu.net>

For further information or to provide feedback: <http://www.pedeu.net>

Lead authors: Maria Beatrice Andreucci (Sapienza University of Rome), Francesca Sabatini (University of Bologna), Giulia Turci (Municipality of Cesena, University of Bologna), Marco Delli Paoli (Sapienza University of Rome)

Contributing authors: József Kádár (Arava Institute for Environmental Studies), Anna Mutule (Institute of Physical Energetics Riga), Juliana Zapata (ZHAW), Michelle Scacco (ZHAW), Cristiana Croitoru (Technical University of Civil Engineering Bucharest), Nienke Maas (TNO), Emanuela Giancola (CIEMAT), Ioanna Kyprianou (The Cyprus Institute), Danila Longo (University of Bologna), Maria Nuria Sánchez (CIEMAT), Silvia Soutullo (CIEMAT), Lina Murauskaite (Lithuanian Energy Institute), Xingxing Zhang (Dalarna University), Paolo Civiero (Roma Tre University), Adriano Bisello (EURAC), Ghazal Etminan (AIT), Oscar Seco (CIEMAT), Jelena Brajković (University of Belgrade), Siddharth Sareen (University of Stavanger).

Scientific Committee: Vicky Albert-Seifried (Fraunhofer), Laura Aelenei (LNEG), Maria Beatrice Andreucci (Sapienza University of Rome), Siddharth Sareen (University of Stavanger), Michal Kuzmic (Czech Technical University in Prague), Nienke Maas (TNO), Ghazal Etminan (AIT), Jelena Brajković (University of Belgrade), Paolo Civiero (Roma Tre University), Savis Gohari (NTNU), Oscar Seco (CIEMAT), Mari Hukkalainen (VTT).

Design: Marco Delli Paoli (Sapienza University of Rome).

Translation to Albanian: Altin Maraj (Polytechnic University of Tirana), Alban Kuriqi (Universidade de Lisboa), Bahri Prebreza (University of Pristina).

Date: June 2024

Version: 1.0

Disclaimer. This publication and the material herein are provided «as is». All reasonable precautions have been taken by PED-EU-NET to verify the reliability of the material in this publication. However, neither PED-EU-NET nor any of its members, data or other third-party content providers provides a warranty of any kind, either expressed or implied, and they accept no responsibility or liability with regard to the use of this publication or the material herein. The information contained herein does not necessarily represent the views of all Members of PED-EU-NET. Mention of specific companies, projects or products does not imply any endorsement or recommendation. The designations employed and the presentation of material herein do not imply the expression of any opinion on the part of PED-EU-NET concerning the legal status of any region, country, territory, city or area, or of its authorities.

1	KUPTO Sfidat e Rajoneve me Energji Pozitive (PED), mundësitë dhe elementet kryesore drejtuese	2
2	MËSO Një fokusim mbi problemet energjitike dhe zgjidhjet e disponueshme	10
3	AKTIVIZO Si mund të kontribuojnë qytetarët në kalimin drejt Neutralitetit Klimatik	30
4	FJALORTH i termave kyç	48

1

KUPTO

Sfidat e Rajoneve me Energji Pozitive (PED),
mundësitë dhe elementet kryesore drejtuese



Smart Energy Åland (Finlanda)
Copyright: Flexens

Në qytete realizohet pjesa më e madhe e aktiviteteve ekonomike, bashkëveprimi ndërmjet njerëzve, inovacionet me karakter social dhe ato me karakter teknologjik. Pavarësisht, se ato përbëjnë çështje shumë të rëndësishme për planetin tonë, gjithashtu hasen sfida të mëdha që lidhen me ndotjen e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, mbingrohjen në hapësirat e mjediseve të banimit, përmbajtjet intensive dhe problemet me shëndetin, të cilat mund të reduktojnë cilësinë e jetës.

Transformimi i qyteteve në sisteme me burime energjitike të pastra dhe si entitete të pavarura energjitike shkon përtej objektivave për një mjedis të gjelbër. Ky transformim krijon mundësi të pafundme për të siguruar një të ardhme të shkëlqyer dhe të qëndrueshme. Rajonet (Distriktet) me Energji Pozitive (PED) përbëjnë bërthamën e përpjekjeve që lidhen me impaktin e tyre pozitiv në shoqëri. Gjithashtu, Rajonet me Energji Pozitive (PED) ofrojnë mënyra për të patur njëkohësisht një ndikim më të vogël “negativ” dhe më të madh “pozitiv”.

Imagjinoni një vend ku inovacioni përputhet me zhvillimin e qëndrueshëm, ku inovacionet teknologjike dhe teknikat përkatëse mjedisore

redukojnë emetimet dhe në të njëjtën kohë ndikojnë pozitivisht në mirëqënien dhe mënyrën lokale të jetesës. Vende të tilla janë qytetet, ku progresi është i vazhdueshëm dhe ku gjelbërimi është më shumë se një ngjyrë: ai përbën një mënyrë jetese.

Mekanizmat e fuqishëm të ndryshimit krijojnë mundësinë për të siguruar zgjidhje të tilla. Zërat e qytetarëve që kërkojnë ajër më të pastër dhe një cilësi më të lartë jetese kanë marrë një vëmendje shumë të madhe. Njerëzit janë veçanërisht të interesuar për të shijuar parqet e gjelbëruara dhe të jetojnë në zona urbane të qeta dhe paqësore. Ky entuziazëm ndikon pozitivisht në fuqizimin e vizionit për Rajonet me Energji Pozitive (PED).

Rrugëtimi për implementimin e PED paraqitet mjaft sfidues. Pengesat përfshijnë kufizime financiare, rezistencë për të ndryshuar, konflikte për shpërndarjen e drejtë të burimeve dhe çështje të ndryshme teknike. Sfidat e hasura akoma karakterizohen nga qasje të ndryshme. Kapërcimi i pengesave mund të sigurohet nëpërmjet evidentimit të problemeve dhe të përshtatjes së tyre për secilin rast.

Shumë qytete Evropiane synojnë të shërbejnë si modele globale për tranzicionin energjetik. Ndërtesat luajnë një rol kyç në këtë drejtim. Transformimi drejt PED është i përqendruar nga ndërtesat individuale me energji zero (ZEB) drejt ndërtesave të ndërlidhura, duke krijuar zona/rajone më të mëdha, në të cilat energjia e gjeneruar nga burimet e ripërtëritsh-



Njerëzit



Mjedis



Energjisë



Ekonomia

me është më e lartë se vlera e energjisë së kërkuar prej tyre. Rajonet me Energji Pozitive (PED) variojnë nga ato me ndërtesa egzistuese deri në ato me ndërtesa të sapo ndërtuara, duke ndeshur një sërë sfidash. Në mënyrë që Rajonet me Energji Pozitive (PED) të realizohen me sukses, nevojitet një qeverisje sa më e gjerë dhe nevojitet angazhimi i komunitetit në planifikimin, në vendimmarrjen, në mbështetjen me rregulloret e nevojshme, në mbështetjen financiare dhe në zgjidhjet teknologjike. Bashkitë dhe palët e interesuara për zhvillim urban mund të realizojnë ndryshime të prekshme në zonat që mbulojnë, duke vendosur në qëndër të vëmendjes komunitetin përkatës.

Konvertimi i zonave urbane si emetuese neto të gazrave serë, në Rajone me Energji Pozitive (PED) përbën një angazhim shumë të madh. Ky konvertim kërkon ndryshime infrastrukturore, të mënyrës së të sjellurit, të zakoneve të përditshme, shqyrtimin e mundësive për të përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, teknologjitë e mençura dhe praktikatat e qëndrueshme. Kjo shënon një rrugëtim drejt një të ardhme urbane me harmoni dhe më të gjelbër.



Sfidat

Tranzicioni Energjitik

Mendoni për tranzicionin energjitik në mënyrë të ngjashme me ndryshimin e një makine të vjetër dhe jo-efikase, me një makinë elektrike dhe miqësore me mjedisin. Kjo, i referohet një qyteti të tërë, duke përdorur materiale të përfuara në mënyrë të qëndrueshme. Tranzicioni nga burimet energjitike fosile tradicionale drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë, kërkon një tranzicion në infrastrukturë dhe në teknologji.

Planifikimi Urban dhe Rikonstruksionet

Imagjinoni transformimin e ndërtesave të zakonshme në ndërtesa efikase - kjo është e ngjashme me transformimin e plotë të një zone egzistuese banimi në një zonë miqësore me mjedisin. Përshtatja e strukturave urbane në struktura, të cilat sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm përbën një sfidë logjistike, ekonomike dhe kohore!

Ndryshimi i sjelljes

Përfytyroni sikur banorët e një qyteti të senzibilizohen për të kursyer energji, si për shembull: të fiket ndriçimi kur nuk është i nevojshëm, të përdoret transporti publik, të përdoret një mënyrë jetese që bazohet në gjelbërimin e mjedisit rrethues. Inkurajimi i personave rezident dhe i bizneseve për të adoptuar praktika të qëndrueshme dhe për të reduktuar përdorimin e energjisë mund të hasë në një lloj rezistence për ndryshim.



Mundësitë/Elementet drejtuese

Tranzicioni Energjitik

Kalimi në secilin aktivitet njerëzor, nga përdorimi i burimeve energjitike fosile drejt burimeve që gjenerojnë emetime shumë të kufizuara të gazrave serë. Kjo mund të arrihet duke përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke zëvendësuar burimet energjitike fosile dhe duke promovuar përdorimin efikas të energjisë, me qëllim reduktimin e kërkesës për energji.

Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

Shfrytëzimi i energjisë diellore, energjisë së erës dhe energjisë hidrike për të mbuluar nevojat e qyteteve për energji - kjo është e njëjtë me konsiderimin e natyrës si një burim energjie personale për një qytet.

Teknologjitë e mençura

Imagjinoni një qytet ku çdo pajisje e lidhur me rrjetin është e optimizuar në lidhje me konsumin e energjisë - kjo është e njëjtë me konvertimin e qytetit në një kompjuter gjigant dhe efikas, i cili menaxhon përdorimin e energjisë në mënyrë efikase.

Infrastruktura e gjelbër

Imagjinoni një qytet të zbukuruar me parqe të stolisura, ndërtesa të ndërtuara me materiale ekologjike dhe me transport publik elektrik - kjo është e njëjtë me krijimin e një qyteti, i cili është i harmonizuar me natyrën, në vend që ta shfrytëzojë atë.

Inovacionet ekonomike

Imagjinoni një qytet ku bizneset, të cilat ushtrojnë aktivitete miqësore me mjedisin shtohen vazhdimisht në numër, duke krijuar mundësi të reja punësimi - kjo është e njëjtë me ngritjen e një qendre të inovacionit, ku mund të zhvillohen mjedisi dhe ekonomitë lokale.



Implementimi i suksesshëm i Rajoneve me Energji Pozitive (PED) paraqet sfida dhe mundësi të shumta gjatë planifikimit të integruar, inovacionit teknologjik, financimit, angazhimit të komunitetit dhe kuadrit rregullator. Tejkalmimi i këtyre pengesave dhe shfrytëzimi i elementeve drejtuese kërkon përpjekje të përbashkëta, zgjidhje innovative dhe përkushtim të vazhdueshëm nga qeveria, aktorët e interesuar dhe komuniteti. Ky përkushtim i përbashkët është shumë i rëndësishëm për të shfrytëzuar potencialin egzistues për implementimin e Rajoneve me Energji Pozitive (PED) dhe për krijimin e qyteteve të përshatshme dhe të qëndrueshme në të ardhmen.


2

MËSO

Një fokusim mbi problemet energjitike dhe zgjidhjet e disponueshme

Keni informacion në lidhje me Rajonet me Energji Pozitive (PED)?

Rajonet me Energji Pozitive (PED) përfaqësojnë vizionin që Evropa ka për qytetet tona në lidhje me dekarbonizimin deri në vitin 2050, duke synuar një mjedis rekreativ dhe të jetueshëm. Ato janë zona urbane të cilat gjenerojnë dhe këmbëjnë energjinë e tepërt të siguruar nga burimet e rritshme. Zhvillimi urban promovon pavarësinë energjitike në zona të ndryshme të qyteteve, në mënyrë të tillë që ndarja e qyteteve të bazohet edhe në nivelin e kërkesës për energji. Në shkallë rajonale, ajo bëhet më e lehtë për të ndërhyrë dhe për të përshtatur objektivat që lidhen me reduktimin e konsumit të energjisë, vlerësimin e saktë të potencialit për përdorimin në shkallë lokale të energjive të Ripërtëritshme dhe senzibilizimin e sensit të jetesës në komunitet.



Kur një ndërtesë individuale mund të mos jetë e pavaruar nga ana energjitike, grupimi i një bashkësie ndërtesash me qëllim rregullimin e saktë dhe fleksibil të kërkesës për energji që lidhet me gjenerimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, parashikimin e energjisë së kërkuar në rajon, fleksibilitetin energjistik nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të mençura dhe në kufizimin e energjisë së depozituar. Inovacione të tilla në shkallë urbane shoqërohen me kursime mujore në lidhje me energjinë elektrike, ngarkesën ngrohëse/ftohëse dhe prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e ajrit nëpërmjet reduktimit të emetimeve në atmosferë. Përveç kësaj, energjia elektrike e tepërt e gjeneruar në këtë hapësirë mund të përdoret për të karikuar makinat elektrike duke shfrytëzuar tarifat e ulëta dhe duke ndihmuar në balancimin e rrjetit elektroenergjitik.

Objekti i 7-të i Zhvillimit të Qëndrueshëm i Kombeve të Bashkuara:
Sigurimi i çasjes në përdorimin e energjisë me çmim të përballueshëm,
në mënyrë të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë

Gjatë jetës së përditshme, njerëzit varet nga energjia! Njerëzit kanë nevojë që të kenë nivele të mjaftueshme të ngrohjes, ftohjes dhe ndriçimit në shtëpitë e tyre, në mënyrë që të sigurojnë një standard të përshatshëm jetese dhe për të garantuar shëndetin e tyre. Fenomeni social i njohur me termin “varfëri energjitike” njihet si mungesa e çasjes në shërbimet energjitike bazë. Pavarësisht, se Bashkimi Evropian (EU) është i përkushtuar për të luftuar varfërinë energjitike dhe për të siguruar çasje në shërbimet dhe produktet energjitike bazë për konsumatorët me pamundësi financiare, rreth 40 milion qytetarë evropian në shtetet anëtare, ose rreth 9.3 % e popullsisë së EU-së, e patën të pamundur të mbanin banesat e tyre mjaftueshmërisht ngrohtë në vitin 2022. Gjithashtu, në këtë vit rreth 6.9 % e popullsisë së EU-së kishin fatura të prapambetura për shërbimet e marra (energji elektrike, gaz, etj).

Në shumë raste, kjo situatë është kryesisht pasojë e tre shkaqeve që lidhen me shpenzimet e larta të faturave të energjisë në proporcion me buxhtin familjar, nivelin e ulët të të ardhurave dhe performancën e ulët energjitike të ndërtesave dhe të pajisjeve. Gjithashtu, du-

hen marrë në konsideratë edhe faktorë të tillë si çasja, cilësia dhe luhatjet e parametrave të energjisë elektrike. Kombinimi i këtyre faktorëve për konsumatorët me pamundësi financiarisht mund të shkaktojë reduktimin e shërbimeve elementare të energjisë, duke ndikuar direkt në mirëqënien e tyre.

Situata e banesave mund të ndikohet më tej edhe nga faktorët gjeografik dhe ata klimatik, karakteristikat e familjeve, gjinia, gjendja shëndetësore, energjia e kërkuar për secilën banesë dhe nevoja për transport. Për këto arsye, banesat me konsum më të lartë të energjisë, të cilat përfshijnë familje me fëmijë, persona me nevoja të veçanta dhe persona të moshuar janë më të ndjeshme ndaj varfërisë energjitike dhe ndikimeve të saj. Gratë, veçanërisht ato që janë prindër të vetëm dhe gratë e moshuara, janë veçanërisht të prekura nga varfëria energjitike. Kjo, për shkak të pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave dhe në statusin shoqëror dhe ekonomik.

Vështirësitë nuk janë të kufizuara vetëm tek qytetarët me të ardhura të ulëta dhe me pamundësi financiare, të cilët shpenzojnë një përqindje më të lartë të të ardhurave të tyre për energjinë. Por, gjithashtu ato prekin edhe shumë qytetarë me të ardhura të mesme. Varfëria energjitike mbetet një çështje shumë e rëndësishme në Bashkimin Evropian, i cili është duke punuar për të trajtuar shkaqet e saj, nëpërmjet masave strukturore dhe objektivave përkatëse. Kjo, për shkak të natyrës personale, ndikimit në banesa dhe kompleksitetit të varfërisë energjitike.



Hapësirat e banimit që të jenë inovative dhe me efikasitet të lartë energjitike duhet të projektohen në përputhje me tranzicionin energjitik. Tranzicioni energjitik përbën një zhvendosje totale në mënyrën sesi ne gjenerojmë dhe konsumojmë energji, duke zëvendësuar lëndët djegëse fosile me burimet e ripërtëritshme, të cilat janë të fokusuar në dekarbonizimin dhe në inovacionet e mençura. Megjithatë, është shumë e rëndësishme për të integruar çështjet e drejtësisë dhe të mirëqënies që në fillim të këtij procesi. Kjo, siguron që furnizimi bazë i banorëve dhe mundësitë jo vetëm të ruhen, por edhe të përmirësohen. Përshtatja e transformimeve të nxitura nga teknologjitë e mençura dhe inovacionet në sistemet me emetim të ulët të gazrave serë po kërkohet gjithmonë e më shumë. Kjo, për shkak të vlerësimit të nevojave të individëve të ndryshëm, duke marrë në konsideratë çështje të tilla, si varfëria energjitike dhe problemet juridike. Lidhja ndërmjet tranzicionit energjitik dhe rezultateve të dëshirueshme sociale për një "tranzicion të drejtë" duhet të analizohen në fokusin e Rajoneve me Energji Pozitive (PED) mbi tranzicionin urban.

Njëra nga objektivat kryesore të Bashkimit Evropian është rinovimi i ndërtesave publike dhe atyre private. Kjo është e rëndësishme për të përmirësuar eficiencën energjitike të tyre dhe për plotësuar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në kuadër të këtyre objektivave, Komisioni Evropian ka publikuar Strategjinë e Valës së Rinovimit. Strategjia synon që deri në vitin 2030, të dyfishohet norma vjetore e rinovimeve me karakter energjistik të ndërtesave, të reduktohen emetimet e gazrave serë, të krijohen vende pune të gjelbra në sektorin e ndërtimit dhe të përmirësohet standardi i jetesës.

Për të arritur këto objektiva, janë evidentuar tre fusha prioritare: trajtimi i varfërisë energjitike dhe ndërtesave me performancën më të ulët energjitike, rritja e shkallës së rinovimeve të ndërtesave publike, dhe nxitja e dekarbonizimit të sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes. Përmirësimi i performancës energjitike të ndërtesave mund të reduktojë efektet negative sociale dhe të maksimizojë përfitimet sociale. Gjithashtu, kjo do të shoqërohet me përmirësimin e kushteve të jetesës në ndërtesat me performancën më të ulët energjitike dhe për të zbutur ose

parandaluar varfërinë energjitike. Duke i dhënë prioritet rinovimit të ndërtesave me performancën më të ulët energjitike, krijohet mundësia që të ndikohet në mënyrë direkte varfëria energjitike. Kjo, sepse njerëzit e prekur nga varfëria energjitike dhe njerëzit me pamundësi tentojnë të banojnë në të tilla ndërtesa.

Nëpërmjet rinovimeve energjitike të ndërtesave, nevoja për energji për ngrohje dhe ftohje të tyre mund të reduktohet ndjeshëm. Kjo, krijon mundësinë që banorët e ndërtesave të rinovuara të mund të shijojnë komfortin termik të tyre, duke patur njëkohësisht fatura energjitike të përballueshme.

Nga këndvështrimi i ndërtesave të reja dhe rehabilitimi i atyre egzistuese, integrimi i tyre dhe përdorimi i sistemeve të gjenerimit të energjisë me eficiencë të lartë dhe që shfrytëzojnë burimet e ripërtëritshme, siguron kushtet e duhura për të përfutur sisteme të mençura, me konsum të ulët të energjisë dhe promovon përdorimin e burimeve të ripërtëritshme lokale në qytete. Përveç këtyre, rritja e shkallës së rinovimeve energjitike të ndërtesave mund të gjenerojë dhe të ruajë vendet e punës, të cilat në mënyrë indirekte kontribuojnë në mirëqënien e popullatës. Parimet e eficiencës energjitike aplikohen gjithashtu edhe në pajisjet shtëpiake, të cilat kontribuojnë në kursimin e energjisë. Standardet për eficiencën e energjisë të aplikuara nëpërmjet projekteve ekologjike dhe etiketimit energjistik mund të shoqërohen me kursime të konsiderueshme të energjisë së konsumuar në ndërtesa.

Sistemet e mençura të matjes, të cilat sigurojnë lexime të sakta dhe në kohë reale, u krijojnë mundësinë përdoruesve që të monitorojnë konsumin aktual të energjisë gjatë gjithë ditës. Kjo, mund të ndihmojë për të identifikuar njerëzit që janë në varfëri energjitike. Përdorimi i tyre ndihmon përdoruesit që të kontrollojnë përdorimin e pajisjeve energjitike në banesë dhe të modifikojnë profilin e ngarkesës energjitike, me qëllim që të kontrollojnë kostot energjitike. Në këtë mënyrë, përdoruesit mund të shmangin problemet me faturimet e energjisë të marrë nga rrjeti/të injektuar në rrjet dhe mund të përfitojnë nga tarifat e ndryshme që mund të aplikohen nga secili operator.

Rinovimi i ndërtesave për të përmirësuar eficiencën energjitike është shumë i rëndësishëm për të reduktuar impaktin mjedisor të ndërtesave dhe për të adresuar ndryshimet klimatike. Faza fillestare e një auditimi energjistik ka si detyrë identifikimin e zonave ku kemi humbje të energjisë dhe të rendisim përmirësimet përkatëse. Vlerësimet energjitike profesionale mund të ndihmojnë në identifikimin e mundësive për përmirësim.

Masat kryesore përfshijnë përmirësimin e termoizolimit egzistues dhe mbylljen e hapësirave të ndryshme. Kjo është e lidhur me minimizimin e humbjeve termike dhe të infiltrimeve të ajrit. Instalimi i dritareve dhe dyerve me performancë të lartë energjitike redukton nevojën për ndriçim artificial. Ndërsa, rinovimi i sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe ajrit të kondicionuar në modele me eficiencë të lartë dhe me termostate të programueshëm ndihmon në optimizimin e temperaturës së dëshiruar. Ndriçimi efikas LED, së bashku me kontrollin e ndriçimit duke përdorur sensorët e pranisë dhe sistemet e kapjes

së dritës natyrale janë shumë të rëndësishëm për të përmirësuar eficiencën në ndërtesë. Riciklimi i paisjeve në fund të ciklit të jetës, zëvendësimi i pajisjeve të vjetra me pajisje të reja dhe me klasë më të lartë energjitike përbën një masë të rekomandueshme. Aplikimi i pajisjeve për kursimin e ujit, parimet e projektimit pasiv, materialet e qëndrueshme dhe teknologjitë e mençura shërbejnë për të përmirësuar eficiencën energjitike të ndërtesave. Përveç kësaj, për të maksimizuar komfortin e përdoruesve të ndërtesës dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, mund të shfrytëzohet: drita natyrale, vlerësimi i ciklit të jetës dhe rivlerësimi i infrastrukturës egzistuese nëpërmjet rinovimit. Gjithashtu, nuk duhet neglizhuar edukimi i stafit dhe trajnimi i banorëve, i cili luan një rol thelbësor në maksimizimin e përfitimit nga këto masa.

Efektet pozitive të rinovimit të ndërtesave dhe kushteve të jetesës mund të maksimizohen nëpërmjet iniciativës së integruar të Rajoneve me Energji Pozitive (PED). Kjo, duke e konsideruar si të lidhur me njësi administrative, veçanërisht kur rinovimi energjistik është i integruar në skemat e nxitjes që lidhen me taksat dhe me programet e regjenerimit të zonave urbane. Gjithashtu, cilësia e hapësirave të jashtme ka rëndësi ekuivalente. Hapësirat publike të projektuara në mënyrë të përshtatshme përmirësojnë cilësinë e jetesës në njësi administrative/rajone dhe reduktojnë ndikimin e ndryshimeve klimatike në qytete. Këto hapësira duhet të përfshijnë gjelbërim, sipërfaqe të hapura, burime ujore dhe zona me hijëzim. Këto të fundit reduktojnë ishujt e nxehtësisë dhe sigurojnë mbrojtje për njerëzit gjatë valëve të të nxehtit.

Një aspekt tjetër që duhet marrë në konsideratë në qytete është transporti (mobiliteti), i cili është një sektor me konsum të lartë të energjisë dhe që mbulohet kryesisht nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse fosile. Elektrifikimi i flotës së automjeteve të transportit në rajone/njësi administrative/qytete, së bashku me masat që lidhen me eficiencën energjitike në ndërtesa janë thelbësore për reduktimin e varësisë nga burimet fosile të energjisë dhe për reduktimin e emetimeve të gazrave serë në qytete.

Rajonet me Energji Pozitive (PED) kërkojnë adoptimin e një sistemi transporti aktiv, të integruar dhe të përbashkët. Duke ndjekur paradigmen "ndaj, ndrysho dhe përmirëso", sistemi i transportit urban pritet që të shmang udhëtimet e panevojshme duke u bazuar në konceptin e 15-minutave. Kjo, për të ndryshuar mendësinë drejt përdorimit të transportit aktiv me biçikletë ose në këmbë për distanca të shkurtra dhe të transportit publik për lëvizjet e përditshme dhe për të përmirësuar lidhjet në terma të sigurisë, eficiencës dhe shpeshtësisë. Kjo mund të përkthehet në veprime praktike, të cilat synojnë në reduktimin e udhëtimeve të përditshme me makinë, duke përdorur shërbimet e

përbashkëta të transportit (psh: përdorimi i përbashkët i makinave, biçikletave, etj.), transporti publik (psh: përdorimi i aplikacioneve për të kontrolluar opsionet e transportit me disa mënyra autobus, tramvaj, metro, anije), dhe përdorimin e gjerë të biçikletave normale dhe atyre elektrike (psh: kërkimi për korsi të lira dhe të mirëmbajtura biçikletash për udhëtimet e përditshme).

Rajonet me Energji Pozitive (PED) përfshijnë preferencën për përdorimin e mjeteve elektrike të transportit, kur kjo është e mundur. Në shumë qytete egziston koncepti i transportit elektrik nëpërmjet përdorimit të përbashkët të biçikletave elektrike ose makinave elektrike. Pavarësisht se siguri i këtyre mjeteve është akoma i pamundur për shumë njerëz, shërbime të tilla mbështesin adoptimin e mënyrave të reja të transportit brenda qyteteve, duke reduktuar trafikun dhe emetimet - dhe si rrjedhim duke reduktuar kohën e ndërrimeve të mjeteve të transportit dhe duke përmirësuar cilësinë e ajrit.

Promovimi i infrastrukturës së karikimit për mjetet elektrike duhet të inkurajohet në të gjitha rajonet. Individët dhe komunitetet energjitike duhet të inkurajohen për të instaluar pikat e karikimit për mjetet e tyre. Ndërsa, në hapësirat publike instalimi i pikave të karikimit mund të arrihet nëpërmjet Këshillave të qyteteve.




Sfidat me të cilat ballafaqohet Evropa në fushën e energjisë përfshijnë çështje si rritja e varësisë nga importet, diversifikimi i kufizuar, çmimet e larta të energjisë, rritja e kërkesës globale për energji, rreziqet e sigurisë të vendeve prodhuese dhe vendeve tranzite, ose kërcënimeve në rritje të ndryshimeve klimatike. Për të zvogëluar këto efekte, është e nevojshme të ndërmerren masa që nxisin diversifikimin e burimeve të energjisë, reduktimin e karburanteve fosile dhe zvogëlimin e konsumit të energjisë. Eliminimi gradual i karburanteve fosile dhe zëvendësimi i tyre me burime të ripërtëritshme është çelësi për adaptimin dhe zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. Marrëveshja e Gjellbër Europiane përcakton parimin se "askush nuk lihet pas", që është shumë e rëndësishme në këtë kontekst. Kalimi nga karburantet fosile në burime të ripërtëritshme më të lira për furnizimin me energji është një element qendror i Rajoneve me Energji Pozitive - PED, së bashku me eficiencën e energjisë dhe fleksibilitetin e energjisë.

Burimet e ripërtëritshme të gjenerimit që mund të implementohen në mjedisin urban zakonisht janë dielli

(fotovoltaike, termike dhe hibride), era, gjeotermike, biomasa dhe biogazi. Për të reduktuar mospërputhjen midis prodhimit të ripërtëritshëm dhe kërkesës së ndërtesave, duhet të implementohen sisteme të ruajtjes së energjisë. Këto sisteme mund të implementohen në ndërtesa (bateri, superkondensatorë, qelula karburantësh, etj), ose virtualisht duke përdorur rrjetet e energjisë si ndërmjetësues: derdhja e të gjithë energjisë së pa konsumuar ose blerja e energjisë kur nevojat e ndërtesave nuk mund të plotësohen lokalisht.

